



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 60

Prishtinë, më 19.10.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selimi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli dhe Zarife Aliu

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 05.09.2012;**
- 3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit Nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil;**
- 4. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;**
- 5. Të ndryshme**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e rendit të ditës.*

1. Miratimi i Rendit të ditës.

Kryetari i Komisionit- Filloi takimin e radhës së Komisionit, me miratimin e Rendit të Ditës i cili u miratua me disa ndryshime.

Propozoi që në këtë takim të bëhet një vlerësim i gjendja së krijuar me datën 17 dhe 18 tetor 2012, në institucionet e Kosovës dhe komunikimin e tyre dhe mënyrën e sjelljes së Policisë së Kosovës. Për këtë arsye propozoi që për situatën e krijuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme duhet të sillet raport për zhvillimet e datës 17 dhe 18 tetor, 2012, dhe pas pranimi të raporteve të bëhet vlerësimi nga ana e Komisionit dhe se në këtë takim të mos bëhet vlerësim i thelluar.

Rexhep Selimi- Propozoi që në pikën e rendit të ditës të futet vlerësimi i situatës nga ana e Komisionit, pastaj në këtë pikë mund të kërkohet ndërmarrja e veprimeve nga ana e institucioneve kompetente.

Fatmir Xhelili- Për propozimin e Kryetarit, tha se e mbështet idenë për kërkimin e një raporti me shkrim nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme për situatën e krijuar, dhe pas pranimi të këtij raporti mund të jetë pikë e rendit të ditës, pasi nëse do të jetë në këtë takim, nuk kemi se në çfarë të bazohemi për vlerësimin e situatës së krijuar me datë 17 dhe 18 tetor, 2012.

Kryetari i Komisionit- Për pikat e rendit të ditës për mbledhjen e Komisionit, tha se përpilimi i tyre është bërë para se të ndodhin ngjarjet, prandaj propozoi që nëse anëtarët pajtohen që kjo çështje të hyjë në rend dite dhe më pas të kërkohet raport nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe pastaj të bëhet vlerësimi për ngjarjet.

Rexhep Selimi- Kërkoj nga Komisioni që në rend të ditës të hyjë vlerësimi i situatës së krijuar pas protestës së 17 dhe 18 tetorit, 2012.

Anton Quni- Për çështjen e ngritur, tha se e mbështet idenë që të jepet qëndrim i Komisionit për situatën e krijuar pas protestës së 17-18 tetorit, duke konsideruar se Raporti për këto ngjarje ndihmon, por vlerësoi se mund të bëhet një vlerësim paraprak në mbledhjen e sotme, duke e futur si pikë të veçantë të rendit të ditës.

Goran Marinković- Për ngjarjet e ditëve të fundit, tha se i vjen keq. Gjithashtu përmendi reagimin e Kryetarit të Kuvendit dhe konsideroi se përdorimi i dhunës nuk ka qenë i nevojshëm dhe shtoi se Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, duhet të reagojë në mënyrë adekuate.

Tutje tha se raportimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme për këtë situatë është i nevojshëm, dhe se në këtë raportim do të shihej se sa janë tejkaluar kompetencat nga ana e Policisë së Kosovës, si dhe për situatën në vendkalimin kufitar në Merdare.

Fatmir Xhelili- Për vlerësimin e situatës së krijuar, tha se pajtohet që të bëhet vlerësimi i saj, por kjo duhet të bazuar diku, pasi bëhet vlerësimi për segmente të rëndësishme të sigurisë. Tutje tha se e rëndësishme do të ishte të dihet nëse Policia e Kosovës ka

poseduar informata inteligjente se mund të ndodh diçka, apo nuk e ka pasur këtë informatë, gjithashtu e rëndësishme të dihet është nëse veprimet janë marrë në bazë të vijës informative, apo nëse urdhëresa të tilla janë marrë në vija politike. Për këtë arsye konsideroi se vlerësimi për situatën e 17-18 tetorit, do të duhej të bëhej pas një raporti nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Rexhep Selimi- Për kërkesën e bërë, që në rend të ditës të hyj vlerësimi i situatës së 17-18 tetorit, pyeti nëse pranohet një kërkesë e tillë.

Kryetari i Komisionit- Për këtë çështje, tha se nëse anëtarët e konsiderojnë të nevojshme që të debatohet për atë se çfarë ka ndodhur, kjo çështje mund të futet në rend të ditës, duke mos dhënë konstatime të Komisionit në mungesë të Raportit.

Rexhep Selimi- Për situatën e krijuar, tha se nuk mund të kemi Raport të shpejt dhe real, pasi situata ka marrë konotacione politike, prandaj e konsideroi se kjo çështje duhet të hyjë në rend të ditës.

Kryetari i Komisionit- Pas propozimit që situata e krijuar gjatë dhe pas protestave të datës 17-18 tetor, të hyj në rend të ditës, hodhi në votim, ku me shumicë të votave kjo çështje hyri në rend dite, tutje hapi debatin për këtë çështje.

Vlerësimi i situatës së krijuar gjatë protestave të 17- 18 tetorit 2012.

Rexhep Selimi- Konsideroi se Komisioni duhet të jep një vlerësim paraprak, pasi me datën 17-18 tetor ka ndodhur një ndryshim i gjendjes së sigurisë, pas protestave ka reaguuar Policia e Kosovës e cila përben sektorin që mbikëqyret nga Komisioni, dhe për këtë arsye Komisioni duhet të ketë një Raport nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë. Afërsisht gjashtëdhjetë demonstrues janë arrestuar, ndërsa katër prej tyre janë lënduar dhe kanë kërkuar ndihmë mjekësore.

Përreth hapësirave të Kuvendit të Kosovës është parë një situatë e pa zakonit, ku një numër i konsiderueshëm i policëve kanë qëndruar aty, gjithashtu përmendi deklaratën e Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Bajram Rexhepi, i cili merr përsipër urdhrin e dhënë policisë. Duke iu referua Ligjit të Policisë, ku neni 5 i këtij Ligji rregullon raportin e Ministrit dhe Policisë, dhe konsideroi se në këtë rast duhet vlerësohet nëse është vepruar në bazë të ligjit. Prandaj konsideroi se për këtë çështje, Komisioni duhet të kërkoj Raport nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, dhe më pas të dal me konstatime.

Në përfundim të këtij diskutimi, konsideroi se Ministri i Punëve të Brendshme, ka tejkaluar kompetencat duke vepruar në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit për Policinë e Kosovës.

Anton Quni- Për situatën e krijuar gjatë protestave të 17-18 tetorit, tha se derisa deputetët po përgatiteshin për të debatuar rreth Rezolutës për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe të Serbisë, në ambientet e Kuvendit vërehej një klimë jo normale siç ishte prezenca e theksuar e policëve brenda dhe jashtë Kuvendit. Gjithashtu përmendi deklaratën e Ministrit të Punëve të Brendshme ndaj

deputetëve dhe autoriteteve të larta shtetërore, sipas tij krijonin imazhin e një shoqërie që udhëhiqet nga një aparat i dhunshëm diktatorial.

Tutje theksoi se demonstrimi i forcës para qytetarëve dhe demonstruesve është pjesë e luftës speciale për ushtrimin e presionit dhe frikës ndaj atyre që shprehen ndryshe nga qëndrimet qeveritare. Gjithashtu theksoi se në këtë situatë Policia e Kosovës është keq përdorur, duke iu nënshtruar urdhrave të udhëheqësve politik, duke vlerësuar se në momentet kur duhet një unifikim për çështjen nacionale, ata bëjnë që forcat politike të polarizohet dhe shoqëria në tërësi.

Në vazhdim tha se angazhimi i forcave të policisë pranë Kuvendit të Kosovës dhe kërcënimet e pa matura, janë sulm ndaj vlerave demokratike dhe se, si anëtar i Komisionit kërkon që Policia e Kosovës të përdoret vetëm sipas ligjeve në fuqi, duke iu përmbajtur detyrave sipas prioriteteve, ndërsa nga Ministri i Punëve të Brendshme kërkoi që ti thërras ndërgjegjes si normë morale, ti kërkoj falje qytetarëve dhe ti mbaj duart larg komandimit të Policisë së Kosovës.

Gjithashtu vlerësoi se vetëm me normalizimin e situatës, raportet e brendshme mund të krijojnë parakushtet për normalizimin me fqinjët dhe se në të kundërtën shpenzimi i energjisë do të bëhet duke u marrë me vetveten.

Rasim Demiri- Për ngjarjet e 17-18 tetorit, tha se ka parë nga afër këto ngjarje dhe konsideroi se Policia e Kosovës nuk ka mundur të reagoj ndryshe nga mënyra se si ka reaguar, pasi sipas tij hyrja me dhunë në institucione nuk konsiderohet e lejueshme, pasi institucionet duhet të respektohen. Gjithashtu theksoi se, nuk ka pasur sulme nga ana e policisë gjatë konfrontimeve me protestuesit, ndërsa sjelljen e tyre ndaj deputetëve, tha se policia nuk është dashur të reagoj në atë mënyrë.

Gjithashtu theksoi se tendenca e disa protestuesve ka qenë që të hyjnë me dhunë në ndërtesën e Qeverisë, ndërsa për sjelljen e policisë ndaj deputetëve, ai tha se është dashur të merret në konsideratë imuniteti i tyre dhe fakti se janë përfaqësues të popullit.

Fatmir Xhelili- Për situatën e krijuar pas protestave, tha se kjo situatë mund të shihet në dimensione të ndryshme të diskutimit. Për këtë arsye vlerësoi se si anëtar i Komisionit, e rëndësishme është të shihet nëse Policia e Kosovës ka ushtruar detyrat e veta në bazë të informatave inteligjente për rreziqet e mundshme ndaj institucioneve të Kosovës, dimension tjetër është se cila ka qenë arsye që deputetët e Kuvendit, bashkë me protestuesit, të veprojnë në mënyrën jo të zakonshme për të hyrë në ndërtesën e Qeverisë, si dhe relacioni i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës.

Për këtë arsye është e rëndësishme që pasi Komisioni të ketë Raportin nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, mund të dal me konstatime. Gjithashtu shtoi se nuk pajtohet me cilësimin që bëri z. Quni, për formën e qeverisjes si "diktatoriale".

Goran Marinković- Shprehi keqardhje që nuk pat përkthim për disa minuta kur po fliste z. Rexhep Selimi. Tutje shtroi dy çështje, nëse policia ka tejkaluar autorizimet dhe çështjen nëse demonstruesit kanë qenë të dhunshëm dhe se ndoshta veprimet e tyre mund të kenë rrezikuar institucionet e Kosovës dhe se për këtë çështje duhet të jemi të matur kur diskutojmë. Gjithashtu shtoi se për arsye se përkthimi në gjuhën serbe nuk është në nivel, mundë ta lëshoj këtë mbledhje.

Kryetari i Komisionit- Tha se reagimi i përkthyesit është se, z. Rexhep Selimi ka folur shpejt dhe për këtë arsye nuk ka arritur të përkthej në kohë.

Rexhep Selimi- Kërkoj nga përkthyesi, të sqaroj arsyen se pse nuk ka arritur të përkthej në kohë për z. Marinković? Për të cilën gjë u konstatua se ishin çështje teknike.

Emin Gerbeshi- Për situatën e krijuar gjatë dhe pas protestave të 17-18 tetorit, tha se reagimi i policisë ndaj deputetëve nuk është dashur të jetë në atë mënyrë, ndërsa vlerësimi për situatën mund të bëhet pas pranimit të Raportit nga institucionet përkatëse. Për protestat e zhvilluara nga ana e Lëvizjes Vetëvendosja, tha se e konsideron të arsyeshme reagimin ndaj procesit të privatizimit. Gjithashtu tha se ka vërejtje për mënyrën e komandimit duke e cilësuar atë si politik si dhe e konsideroi prezencën e policisë në hapësirat e Kuvendit si të pa nevojshme dhe si një situatë jo e zakonshme.

Rexhep Selimi- Për diskutimin e situatës së krijuar, tha se do ti shërbej Raportit që do ti paraqitet Kuvendit, duke mos paragjykuar veprimin e Policisë së Kosovës por duhet të theksojmë urdhrin e dhënë policisë që të reagoj. Gjithashtu vlerësoi se policia është urdhëruar të futet në ambientet e Kuvendit pa arsyen e duhur. Nëse policia do të ishte e mbështetur në informata inteligjente, një gjë e tillë është dashur të tregohet, ndërsa në të kundërtën, numri i madh i policëve mund të bëhet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe kjo do të duhej të informohej.

Gjithashtu shtoi se nuk pajtohet me vlerësimin se deputetët bashkë me protestuesit, i janë drejtuar në mënyrë të dhunshme ndërtesës së Qeverisë dhe se kjo nuk qëndron, pasi sipas tij është shfrytëzuar të drejtën për të pasur qasje në institucionet publike. Tutje ai tha se ka qenë e pa arsyeshme angazhimi i truporave dhe personave që nuk janë kompetente për të mbrojtur objektet e Qeverisë së Kosovës, për këtë arsye tha se kontestohet urdhri i dhënë policisë për të reaguar ndaj deputetëve.

Për situatën e krijuar gjatë protestës e vlerësoi të nevojshme kërkimin e një raporti nga IPK-ja, për shkallën e përdorimit të dhunës ndaj protestuesve dhe tejkallimin e etikës profesionale.

Anton Quni- Për analizimin e situatës së krijuar tha se, nuk është marrë me analizimin e teknikave të policisë, por për imazhin i cili është krijuar pas kësaj situatë dhe përmendi numrin e pa nevojshme të zyrtarëve policor në hapësirat e Kuvendit, duke theksuar që një ambient i tillë nuk karakterizon shtetet demokratike.

Goran Marinkoć- Për ngjarjet e 17- 18 tetorit, tha se nuk ka qenë dëshmitar i tyre dhe nuk mund të bëj konstatime dhe se nga ajo çfarë ka ndodhur ka parë vetëm disa sekuenca. Tutje konsideroi se pa një Raport të Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk mund të konstatohet se çfarë ka ndodhur gjatë këtyre ngjarjeve.

Gjithashtu tha se, do të ishte e obligueshme për Ministrin e Punëve të Brendshme për një raportim të asaj se për çfarë arsye ka ardhur deri tek kjo situatë, duke konkluduar se pa një Raport të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, nuk mund të jepet vlerësim për situatën.

Fatmir Xhelili- Për situatën e krijuar gjatë protestës dhe për imazhin e krijuar, tha se duhet të dihen faktorët e krijimit të këtij imazhi, duke theksuar se deputetët duhet të sillen konform normave të caktuara që i obligojnë ata si deputet të Kuvendit të Kosovës.

Rexhep Selimi- Duke iu referuar fjalisë së z. Xhelili, tha se sjelljet e deputetëve gjatë protestës nuk kanë qenë jashtë të drejtave që u takojnë si deputet. Gjithashtu shtoi se duhet të theksohet se cila nga sjelljet nuk ka qenë në përputhje me ligjin, ndërsa në të kundërtën një vlerësim të tillë e konsideron si politik.

Fatmir Xhelili- Për vlerësimin e sjelljes së deputetëve tha se, nuk është kompetent por nuk e konsideron si të denjë mënyrën e sjelljes së tyre, në rastet kur nënshkruhen kontrata të rëndësishme për Kosovën. Gjithashtu tha se nuk ka qenë i kënaqur për raportin e krijuar gjatë kësaj situatë mes Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, por vlerësimi i kësaj situatë do të bëhet pas posedimit të raporteve dhe të dhënave për këto ngjarje.

Kryetari i Komisionit- Për vlerësimin e situatës tha se e konsideron të rëndësishme dhe se veprimet e deputetëve dhe institucioneve përkatëse duhet të bëhen konform ligjeve. Ndërsa për çështjen e tejkallimit të kompetencave, tha se një gjë e tillë është e rregulluar me Ligjin për Policinë e Kosovës, ndërsa gjatë protestave është parë se është bërë një tejkallim i kompetencave nga ana e Ministrit të Punëve të Brendshme. Ndërsa në rast se policia ka poseduar informacione se duhet të veprojnë në atë mënyrë, kjo duhet të përfshihet në raport, ndërsa për vlerësimin e sjelljes së policisë tha se kjo është bërë në bazë të urdhrat dhe kjo duhet përfshirë në raport, se nga kush u është dhënë urdher.

Në përfundim të kësaj çështje, tha se situata e krijuar gjatë protestave të 17-18 tetorit i ka dhënë një imazh jo të mirë Kosovës, gjithashtu ai tha se pas pranimat të raporteve do të bëhet vlerësimi për situatën dhe nëse raportet janë përfshirëse.

Në përfundim të kësaj pike tha se, në emër të Komisionit i dërgohet kërkesa për Raport, Ministrisë së Punëve të Brendshme, në të cilin Raport përfshihet pjesa e policisë dhe Inspektoratit Policor të Kosovës.

Rexhep Selimi- Për kërkesën e Raportit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, tha se e konsideron të nevojshme kërkimin e raporteve të veçanta edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë dhe Inspektorati Policor, duke qenë se janë sektor që mbikëqyrin nga Komisioni.

Kryetari i Komisionit- Për propozimin e z. Rexhepi, tha se mund të bëhet një kërkesë e tillë ose edhe një Raport të vetëm ku të përfshihen të gjitha të dhënat nga Policia e Kosovës, IPK-ja dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Rexhep Selimi- Konsideroi se do të ishte më arsyeshme që të dërgohen raporte të veçanta nga secili institucion, pasi në këtë mënyrë do të drejtoheshin vetëm Komisionit, duke mos u filtruar në instanca të tjera.

Fatmir Xhelili- Pajtohet që të kërkojnë raporte të veçanta nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës drejtuar Komisionit, ndërsa nga IPK-ja, tha të mos

kërkohet një raport i menjëhershëm, pasi në rast tejkalimit të kompetencave protestuesit i drejtohen këtij institucioni me ankesat përkatëse.

Rexhep Selimi- Tha se pajtohet që pas dërgimit të ankesave pranë IPK-së nga ana e personave që e konsiderojnë se gjatë protestave, Policia e Kosovës ka tejkaluar kompetencat gjatë intervenimit. Gjithashtu vlerësoi se ka pasur tejkalim të kompetencave dhe shkelje procedurale gjatë arrestimit.

Fatmir Xhelili- E konsideroi të arsyeshme që anëtarët e Komisionit u pajtuan që për IPK-në, të mos bëhet kërkimi i raportit për protestat e 17-18 tetorit, pasi një kërkesë e tillë mund të bëhet pas vlerësimit të ankesave të personave ndaj këtij institucioni.

Goran Marinkovič- Gjatë periudhës në të cilën Komisioni ka realizuar mbledhje, tha se kanë ndodhur disa situata me të cilat IPK-ja është dashur të merret me to. Gjithashtu theksoi se nga ana e tij janë theksuar disa çështje me të cilat duhet të merret IPK-ja, tutje shtoi se, si anëtar i Komisionit punon në të mirë të interesit të përgjithshëm.

Në vazhdim shtoi se në Raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, duhet të përfshihet edhe çështja e kalimit të qytetarëve në vendkalimin në Merdare, për sjelljen e disa individëve në mënyrë të pa pranueshme. Gjithashtu vlerësoi se dëmtimi nga ana e disa individëve të vlerave të një shteti demokratik i cili është ndërtuar, nuk përbën shembull të mirë.

Kryetari i Komisionit- Tha se të gjithë anëtarët janë dakord që të ketë një Raport nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe një Raport nga Drejtoria e Policisë së Kosovës për Komisionin. Ndërsa për Raportin nga IPK-ja, tha se në rastet kur mund të ketë vërejtje ndaj sjelljes së policisë dhe masat e ndërmarra ndaj tyre, prandaj në këtë rast mund të kërkohet Raport edhe nga ana e tyre dhe më këtë e konsideroi të mbyllur këtë pikë të rendit të ditës.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 05.09.2012

Kryetari i Komisionit- Konstatoi miratimin e Procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 05.09.2012, i cili u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit Nr. 04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Kryetari i Komisionit- Si praktikë e punës së Komisionit për përpunimin e ligjeve, ai tha se është formimi i grupeve punues që do të merren më të. Për këtë qëllim ftoi anëtarët e Komisionit që të kontribuojnë në grupin punues.

Pas konsultimeve mes anëtarëve, në këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Formohet Grupi punues, për Projektligjin Nr.04/L-160 për Agjencinë e Regjistrimit Civil me këtë përbërje: Anton Quni- Kryesues, Ganimete Musliu, Rexhep Selimi, Gora Marinkovič, anëtar.

4. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kryetari i Komisionit- Për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, propozoi formimin e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatueshmërisë së këtij ligji.

Pas konsultimeve mes anëtarëve, në këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, me vota unanime morri këtë:

VENDIM

Formohet grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale me këtë përbërje: Antom Quni, Kryesues, ndërsa Ganimete Musliu, Rexhep Selimi dhe Goran Marinkovič, anëtar.

5. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit- Njoftoi për anulimin e vizitës e cila ishte paraparë të bëhet në Istog, pranë Brigadës së FSK-së dhe njoftoi se kjo vizitë është shtyrë me datë 23.10.2012. Gjithashtu njoftoi se aktivitetet e grupit punues për Komisionerin për Siguri do të jetë në seminarin në Tiranë, nga data 29-31 tetor, kryesimi i grupit bëhet nga z. Rexhep Selimi.

Rexhep Selimi- Propozoi se para se grupi punues të udhëtoj për Tiranë, anëtarët e grupit punues të realizojnë një takim për koordinimin e aktiviteteve gjatë kësaj punëtorie.

Kryetari i Komisionit- Me këtë pikë të rendit të ditës e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi